Kjo faqe do të ngjitet në kopertinë

Raporti vjetor **2015**

Tanimë është një traditë dhe një detyrim i Kryqit të Kuq Shqiptarë për të botuar Raporti vjetor të veprimtarisë së tij.

Një traditë, sepse çdo vit KKSH ndjen përgjegjësinë për të bërë transparencën e veprimtarive të organizuara, nëpërmjet botimit të këtij raporti dhe një detyrim ndaj të gjithë anëtarëve e vullnetarëve të shoqatës ndaj publikut, e në mënyrë të veçantë, ndaj donatorëve të shumtë që kanë mbështetur veprimtari të ndryshme të shoqatës.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur, të gjithë veprimtarinë e KKSH të zhvilluar gjatë vitit, në programet dhe në projektet në të cilat shoqata është angazhuar dhe ka dhënë kontributin e saj në lehtësimin sadopak të nevojave të grupeve të caktuara në nevojë, gjithnjë në përmbushje të vizionit dhe misionit të saj.

PROGRAMI "PËRGATITJE DHE PËRGJIGJE PËR RASTE KATASTROFASH DHE NDIHMA E PARË"

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Forcimi i strukturave vullnetare të shoqatës për raste katastrofash në përputhje me zhvillimet në vend, Ligjin për Mbrojtjen Civile, Strategjinë për reduktimin e rreziqeve, etj.;
2. Sensibilizimi i publikut të gjerë, i institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore për rreziqet nga katastrofat, si një nga masat kryesore të përgatitjes paraprake për tu përgjigjur nëse ndodhin;
3. Rishikimi dhe kompletimi i kapaciteteve operacionale të shoqatës në rast ndërhyrje në emergjenca.

2015 është viti i zbatimit të strukturës së re të KKSH, strukturë që bashkoi Programin e Përgatitjes dhe Përgjigjes për raste Katastrofash me Programin e Ndihmës së Parë. Si rezultat veprimtaritë e vullnetarëve dhe komunitetit për raste katastrofash janë harmonizuar dhe me transmetimin e njohurive të Ndihmës së Parë (NP) me qëllim konsolidimin e kapaciteteve të shoqatës për një ndërhyrje sa më efektive në raste katastrofash

Viti 2015 nisi me një situatë emergjente të shkaktuar nga përmbytjet në pjesën jug-perëndimore të vendit, përgjatë rrjedhës së lumenjve Vjosë, Osum e Shkumbin, që shkaktuan dëmtime të rënda në 5 qarqet të vendit, më konkretisht në atë të Vlorës, të Fierit, të Beratit, të Gjirokastrës dhe të Elbasanit.

Në një situatë të tillë, fokusi kryesor i punës së KKSH ishte veprimi i shoqatës në ndihmë të njerëzve në nevojë, pa lënë mënjanë realizimin e veprimtarive të programit të planifikuara në Planin e Veprimit 2015.

Përmbytje "Jug 2015": Në Shqipërinë e Jugut dhe atë Qendrore u prekën nga përmbytjet e shkaktuara nga shirat e rrëmbyeshëm rreth 42 000 banorë, u evakuuan 850 familje, u dëmtuan rreth 2 400 shtëpi banimi e biznese, u përmbytën 5000 ha të mbjella, u mbytën rreth 3 500 kafshë shtëpiake, u dëmtuan shumë orendi shtëpiake, etj.

Veprimi i KKSH: Pasi u ngrit Grupi i Menaxhimit të Emergjencës, u mobilizua i gjithë stafi i selisë me detyra konkrete për menaxhimin e emergjencës; përfaqësues të degëve të KKSH morën pjesë në Komisionet e Menaxhimit të Emergjencës të ngritura në Prefektura e Bashki nga autoritetet vendore; degët e KK Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër dhe Elbasani mobilizuan një numër prej

220 vullnetarësh me detyrat përkatëse në raste katastrofash.

Me vlerësimin e situatës në zonat e përmbytura dhe vënien në gatishmëri të kapaciteteve logjistike, materiale e njerëzore të shoqatës, u shpërndanë menjëherë 100 pako ushqimore në KK në zonën e Vlorës, ndërkohë që Shoqata lëshoi një Apel për ndihmë për 2,000 familje në Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të KK dhe të GjK. Këshilli Drejtues i KKSH, i mbledhur posaçërisht për situatën e krijuar, miratoi masat e marrë, ndër të cilat dhe Operacionin e KKSH për të ndihmuar popullsinë e prekur nga përmbytjet.

Operacioni i shpërndarjes ndihmave materiale u zhvillua në dy faza:

Në fazën e parë u shpërndanë ndihma për 2 686 familje: në Vlorë 660 familje; Fier 1485 familje, Berat 371 familje, Gjirokastër 60 familje dhe në Elbasan e Librazhd 110 familje.

Në fazën e dytë, u shpërndanë ndihma për 1775 familje: në Vlorë 390 familje, Fier 801 familje, Berat 195 familje, Gjirokastër 160 familje, Elbasan 94 familje. Në këtë fazë u shpërndanë ndihma për 85 familje në Korçë dhe 50 familje në Dibër, familje këto të prekura nga moti i keq. Në total u ndihmuan 4 461 familje.

Pako standarde e ndihmës familjare për 1 muaj = 50 kg.

Përbërja: miell 30 kg, vaj 4 l, fasule 4 kg, sheqer 4 kg, oriz 4 kg, makarona 4 kg, kripë 0,5 kg, batanije 5 copë, kit higjienik familjar 1 copë.

DONATORËT QË MBËSHTETËN KKSH

	Donatori	Shuma	Përfitues
1	Federata	246 000 CHF	2000 familje
2	Fondacioni "Vodafone Albania" & Vodafone Group	10 000 Paund	
3	KK Gjerman	20 000 Euro	
4	Gjysmëhëna e Kuqe e Emirateve të Bashkuara Arabe	200 000 USD	2200 familje + 4949 pako me veshje për fëmijë
5	TAP (Trans Atlantic Pipeline)	10 000 Euro	
6	Gjysmëhëna e Kuqe Iraniane	100 çadra + 1000 batanije	

Projekti: Ndihmë për ushqime, nëpërmjet ndihmës financiare

Gjatë operacionit të ndihmës në zonat e përmbytura, KKSH fitoi një përvojë e re, falë bashkëpunimit me Organizatën Botërore të Ushqimit (OBU). Kjo organizatë kërkoi bashkëpunimin e KKSH në realizimin e projektit "Ndihmë në ushqime nëpërmjet ndihmës financiare" për familjet e prekura në zonat e përmbytura.

Realizimi i këtij projekti mundi të realizohej falë punës së madhe të kryer nga stafi dhe vullnetarët e KKSH për hartimin e listave sipas kritereve standard të përcaktuara nga OBSH. Me kërkesë të donatorit dhe me përfundimin e listave të përfituesve, KKSH në bashkëpunim me Bankën Intesa San Paolo, bëri shpërndarjen e çeqeve për familjet përfituese. Pas një pune intensive të degëve të KK Vlorë, Fier, Berat, Gjirokastër dhe Elbasani, projekti përfundoi me sukses.

Nga ky projekt fituan 2 217 familje të prekura nga përmbytja, për të cilët u shpërndanë një vlerë totale prej 971 000 dollarë.

Për një vlerësim sa më të plotë të projektit, si një përvojë e parë, në fund të muajit shtator, u organizua në Degën e KK Fier, një takim me të gjithë pjesëmarrësit që dhanë kontributin e tyre në realizimin me sukses të tij. Realizimi i këtij projekti dhe përfshirja e KKSH në disa prej hallkave kryesore të tij, përbën një përvojë mjaft të mirë në eksperiencën e deritanishme të KKSH në përgatitjen dhe ndërhyrjen në raste katastrofash.

Konkursi i 18-të Kombëtar i Ndihmës së Parë (NP). Konkursi kishte për qëllim testimin e njohurive dhe teknikave të vullnetarëve të NP, të trajnuar gjatë vitit dhe sensibilizimin e publikut mbi teknikat dhe mënyrën e dhënies së NP në rastet e aksidenteve dhe më gjerë.

Faza e parë: 1 Mars – 5 Prill 2015 – Konkursi i NP në degë. Morën pjesë 37 degë të KKSH; rreth 115 ekipe; 840 vullnetarë të trajnuar për NP si dhe instruktorët e NP.

Faza e dytë: Në muajin Prill – U zhvilluan tre takime rajonale të NP në Shkodër më 1 prill, në Durrës 25 prill dhe në Fier 2 maj. Në çdo takim morën pjesë 12 ekipe përfaqësues të degëve respektive. Në këtë fazë morën pjesë 36 degë dhe rreth 650 vullnetarë dhe instruktorë të degëve.

Ekipet fituese në takimin rajonal, Shkodër: vendi i parë – dega KK Shkodër; vendi i dytë – dega KK Lezhë; vendi tretë – dega e KK Mat;

Ekipet fituese në takimin rajonal, Durrës: vendi i parë – dega KK Tiranë; vendi i dytë – dega KK Durrës; vendi i tretë – dega KK Librazhd;

Ekipet fituese në takimin rajonal Fier: vendi i parë – dega KK Fier; vendi i dytë – dega KK Lushnje; vendi i tretë - dega KK Kuçovë

Konkursi u zhvillua bazuar në standardet e

krijuara për këtë veprimtari dhe sipas formatit të Konkursin Europian të NP. Në përfundim të çdo takimi, për ekipet fituese u shpërndanë certifikatat respektive.

Faza e tretë: Takimi final i Konkursit Kombëtar të NP, u zhvillua në datën 8 maj, në sheshin "Skënderbe".

Në finale morën pjesë 9 ekipet fituese: respektivisht ekipet e degëve të KK Tiranë, Librazhd, Durrës, Shkodër, Mat, Lezhë, Lushnje, Fieri dhe Kuçovë.

Të gjitha fazat e Konkursit kombëtar të KKSH u realizuan duke respektuar me rigorozitet standardet e Konkursit Europian të NP. Në "5 stacione simulimi" të organizuara, me aksidente të ndryshme, të përgatitur enkas nga vullnetarët simulantë dhe ata të përgatitjes së plagëve, ku vullnetarët demonstruan dhënien e NP për personat e aksidentuar. Simulimi i aksidenteve ishte shumë afër realitetit.

Për herë të parë, në këtë aktivitet mori pjesë dhe ekipi i NP i Kryqit të Kuq të Kosovës, i cili zhvilloi një situatë simulimi demonstrative, duke bërë kështu shkëmbimin e eksperiencave në fushën e NP.

Në përfundim të takimit vendi i parë u fitua nga ekipi i Degës së KK Tiranë, vendi i dytë nga ekipi i degës së KK Shkodër, dhe vendi i tretë nga ekipi i degës së KK Lushnje. Ekipi mik i Kryqit të Kuq të Kosovës ju dha certifikatë pjesëmarrje.

Veprimtari të tjera të zhvilluara gjatë vitit:

• U zhvillua në Bukuresht, Rumani, Konkursi XXVI Evropian i Ndihmës Parë (FACE-2015) në datat 10-13 Shtator 2015. Në konkurs morën pjesë ekipet e 28 shoqatave kombëtare pjesëmarrëse të KK dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ekipi i KKSH bëri një paraqitje mjaft të mirë dhe u rendit në grupin e ekipeve të pozicionuar në vendet 11 deri 20-të.

• Me moton: "Ndihma e Parë dhe mosha e tretë. Bëhu hero! Shpëto jetë! Kushdo, në çdo kohë mund ta japë atë!", u kremtua më 12 shtator, Dita Botërore e NP. Vullnetarë të 38 degëve të KK u angazhuan në veprimtari sensibilizuese për dobinë e NP, në vende publike. Demonstrime të dhënies së NP në rast aksidenti, respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, demonstrim me biçikleta, etj. ishin disa nga veprimtaritë e zhvilluara, me qëllim krijimin e një imazhi pozitiv për moshën e tretë dhe inkurajimin e saj për një përfshirje sa më të gjerë e aktive në shoqëri.

• Rifreskimi i skuadrave të vullnetarëve për raste katastrofash, zëvendësimi dhe rekrutimi i vullnetarëve të rinj, ka qenë një nga detyrat më të rëndësishme të programit, ashtu siç ka qenë dhe testimi i gatishmërisë së këtyre skuadrave. Janë 28 degë që kanë raportuar plotësimin e skuadrave ndërkohë që 12 degë të nivelit të parë kanë realizuar testimin e gatishmërisë së tyre, nga ku rezulton se reagimi dhe gatishmëria është e kënaqshme me rreth 75 % të vullnetarëve.

• KKSH ka ndjekur me vëmendje zhvillimet e krizës së emigrantëve në Europë, dhe te vendet fqinjë me Shqipërinë. Megjithëse vendi ynë nuk është përfshirë në këtë krizë, KKSH ka qenë mjaft aktive në përgatitjen e saj, realizuar kjo në bashkëpunim me UNHCR-në dhe strukturat e azilkërkuesve në Shqipëri, duke ofruar gatishmërinë e shoqatës në përmbushje të misionit të saj humanitar.

• Për një përdorim sa më efikas të stokut me ushqime për raste katastrofash, në bashkëpunim me Programin Social u bë shpërndarja e pakove ushqimore, një sasie mielli dhe kitesh higjienike, gjithsej për 430 familje në nevojë në 26 Degë të KKSH. ■

PROGRAMI SOCIAL, MBLEDHJA E FONDEVE DHE SHËRBIMI I KËRKIMIT

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Përkujdesje social shëndetësore për të moshuarit në nevojë;
2. Mbështetje social-edukative për fëmijë në vështirësi me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në sistemin edukativ dhe integrimit social;
3. Mbështetje sociale për gra dhe vajza në nevojë për shkak të situatës social ekonomike, të papunësisë ose të diskriminimit të tyre;
4. Mbështetje me ushqime dhe me artikuj të tjerë bazikë për familje në nevojë në gjithë vendin.

Gjatë vitit 2015, Programi Social ka punuar për zbatimin e projekteve që sjellin ndryshime reale në jetët e përfituesve, duke ofruar shërbime sociale apo formim profesional në mënyrë që ata të kenë më shumë qasje për punësim, (gratë dhe vajza në nevojë), për një edukim cilësor dhe integrues social (fëmijët në vështirësi), për një shërbim social dhe mjekësor adekuat (mosha e tretë), dhe për një përmirësim të gjendjes ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet mbështetjes ushqimore. Për realizimin e synimeve të mësipërme, Programi ka realizuar disa projekte:

Qendrat ditore për të moshuar

Projektet për moshën e tretë synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në këtë grup-moshe nëpërmjet përkujdesjes psiko-sociale e shëndetësore dhe mbështetjes ekonomike. Këto shërbime ofrohen nga një numër qendrash ditore në degët e KK Tiranë, Lezhë, Fier, Durrës, Dibër, Kuçovë, Korçë, Përmet, Elbasan, Librazhd, Lushnjë, Burrel dhe Gramsh, ku dhe janë identifikuar nevojat më të larta në lidhje me këtë kategori. Më poshtë disa tregues për këtë projekt:

- Qendrat janë frekuentuar nga më shumë se 720 të moshuar. Në to janë organizuar lojëra të ndryshme, veprimtari mbështetëse, vizita mjekësore, takime me specialistë të fushave të ndryshme duke ofruar dhe një pije falas. Me mbështetjen e KK Gjerman, të moshuarit në disa degë kanë pasur mundësi të kryejnë udhëtime të shkurtra si dhe aktivitete jashtë qendrave ditore;
- Për më shumë se 110 të moshuar, që e kanë pasur të pamundur të lëvizin, është siguruar mbështetje me pako ushqimore mujore, dhe në degët e KK Lezhë, Dibër, Burrel, Përmet, Gramsh, Kuçovë, Fier dhe Librazhd ata janë vizituar nga mjeku i angazhuar në projekt;

• Me mbështetjen e projektit të telemjekësisë janë organizuar kontrolle mjekësore për frekuentuesit e disa prej qendrave ditore për të moshuarit. Janë ekzaminuar rreth 80 pacientë dhe janë kryer rreth 250 ekzaminime në Qendrat ditore të degëve të KK Gjirokastër, Elbasan, Durrës;

• Me rastin e 1 Tetorit, Ditës ndërkombëtare të të Moshuarve, rreth 800 të moshuar kanë qenë pjesë e aktiviteteve sociale, dhe mbështetjes ushqimore në gjithë vendin;

• Sërish këtë vit, falënderojmë Bashkitë në Lezhë, Librazhd, Gramsh, Dibër, Burrel dhe Fier të cilat kanë ofruar mbështetje për Qendrat Ditore për të moshuarit që kanë siguruar ambiente për degët respektive të Kryqit të Kuq.

Projekte formimi për gra dhe vajza në nevojë

Projektet sociale të formimit për gra dhe vajza në nevojë kanë kontribuar në fuqizimin e kësaj kategorie, të përbërë kryesisht nga gra të ardhura nga zonat rurale si pasojë e lëvizjeve të brendshme të popullsisë. Projektet kanë synuar rritjen e aftësive profesionale dhe personale të grave, me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës, fuqizimin e tyre dhe arritjen e barazinë gjinore si një çelës suksesi për zhvillim brenda familjes dhe komuniteteve ku jetojnë. Me këtë synim është zbatuar projekti "Integrimi i gruas në tregun e punës" në degët e KK Korçë, Shkodër, Berat, Lezhë (me mbështetjen e KK Gjerman). Në përfundim të këtij projekti:

• 240 gra përfituese përfunduan me sukses kurset 5-mujore duke u specializuar në profesionin e rrobaqepësit;

• Paralelisht me mësimin e profesionit, përfituesve të projektit u është ofruar mbështetje psiko-sociale me qëllimin rritjen e vetë-vlerësimit dhe të forcimit të rolit të tyre në familje;

• 129 gra përfituese të projektit, ose 54% e tyre janë punësuar në kompani private të prodhimit të veshjeve, falë ndërmjetësimit të personelit të KK në degët ku është zbatuar projekti.

Projekte integrimi i fëmijëve në vështirësi

Projekti social-edukativ për fëmijët në vështirësi, ka si qëllim rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në sistemin e edukimit dhe integrimin social të tyre; mbështetjen didaktike të fëmijëve në pamundësi ekonomike për frekuentimin e shkollës dhe zhvillimin e

veprimtarive mbështetëse për institucionet rezidenciale shtetërore të fëmijëve. Për këtë:

• Në degët e KK Tiranë dhe Fier është zbatuar projekti ri-integrimi për 100 fëmijë në vështirësi, me tendencë braktisjen e shkollës. Projekti zhvillohet në shkollat e përzgjedhura, ku fëmijët në vështirësi socio-ekonomike mbështeten me orë shtese mësimore nga mësuesit e projektit për të mundësuar përparimin e tyre, dhe me veprimtari integruese me qëllim përfshirjen e tyre në jetën sociale të vendit;

• Gjatë vitit, në degët e KK Tiranë janë zhvilluar veprimtari social-edukative për 447 fëmijë në institucione rezidenciale shtetërore për fëmijë, në shkolla dhe në komunitet; në degën e KK Korçë mbështetje për 50 fëmijë të komunitetit Rom; në degën e KK Gjirokastër për 30 fëmijë në nevojë, në degën e KK Lezhë me mbështetjen e World Vision për 500 fëmijë.

• Në degët e KK Lezhë, Dibër, Laç dhe Librazhd u organizuan kampe verore për 600 fëmijë të moshave 7-14 vjeç, me mbështetjen e World Vision, ndërsa në degët e KK Tiranë dhe Korçë për 55 fëmijëve me fonde të degës;

• Në degët e KK Korçë, Krujë dhe Tiranë, me kontributin e Telecom Albania, në fillim të vitit shkollor janë mbështetur me kite shkollore rreth 170 fëmijë në vështirësi;

• Në muajin dhjetor, për 445 fëmijë në degët e KK Tiranë, 30 fëmijë në degën e KK Lezhë, 30 fëmijë në degën e KK Berat, 12 fëmijë në degën e KK Kuçovë, 50 fëmijë në degën e KK Vlorë, 25 fëmijë në degën e KK Kukës, janë organizuar veprimtari argëtuese dhe mbështetëse me të gjitha kategoritë e fëmijëve në vështirësitë si në komunitet dhe në institucione.

Mbështetje ushqimore për familjet në nevojë.

Gjatë vitit 2015 janë mbështetur me ushqime në degën e KK Tiranë rreth 500 familje, në degët e KK Korçë, Shkodër, Durrës, Lezhë nga 100 familje; në degët e KK Dibër, Krujë dhe Patos nga 40 familje, si dhe janë ndjekur disa raste sociale në ndihmë të familjeve në kushte ekstreme varfërie si në Bathore, Tiranë, Tepelenë, Vlorë, Rrëshen, etj.

• Për festat e fund vitit janë ndihmuar me paketa ushqimore dhe veshje në rang vendi rreth 1520 familje në vështirësi.

• Nga stoku i programit të përgatitjes për raste

katastrofash janë mbështetur 430 familje në nevojë në 26 rrethe të vendit

• Me mbështetjen e Bankës Credins me një donacion prej 1,000,000 lekë, në prag të Vitit të Ri, janë mbështetur 1,000 familjeve në nevojë në 22 qytete ku kjo bankë operon. Shpërndarja e pakove ushqimore u zhvillua në datën 28 dhjetor në degët e KK Tiranë (100), Kamzë (30), Durrës(50), Shkozet (30), Kavajë (30), Shijak (30), Fushë-Krujë (30), Fier (50),Vlorë (60), Elbasan (50), Korçë (50), Lezhë (60), Shkodër (60), Kukës (50), Lushnjë (50), Burrel (30), Ballsh (30),Dibër (50), Berat (50), Gjirokastër (50), Sarandë (30), Pogradec (30).

Fushatat publike

Gjatë vitit 2015, degët e KK në të gjithë vendin janë angazhuar dhe kanë zhvilluar dy fushata publike:

Fushata në ndihmë të **Fëmijëve në Nevojë** organizuar në periudhën maj-qershor. Në funksion të fushatave janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese e mbështetëse, takime në shkolla, etj. Si rezultat e fondeve të siguruara 515 fëmijë kanë qenë përfitues nga ndihmat e mbledhura nga kjo fushatë.

Kanë qenë përfitues si më poshtë: Dega e KK Tiranë, 150 familje, Lezhë 50 familje, Korçë 100 familje, Elbasan 50 familje, Gjirokastër 50 familje, Berat 50 familje, Kuçovë 15 familje, Pogradec 30 familje, Librazhd 10 familje dhe Gramsh 10 familje.

Fushata në kuadër të **Ditës Botërore kundra Urisë**, ka synuar të sensibilizoj publikun e gjerë për të treguar solidaritetin dhe mbështetjen e tij ndaj shumë njerëzve që luftojnë çdo ditë për të kapërcyer problemet me urinë dhe varfërinë.

Gjithsej janë ndihmuar 1041 familje si më poshtë: Dega e KK Tiranë 392 familje, Vlorë 30 familje, Dibër 61 familje, Durrës 40 familje, Fier 50 familje, Lezhë 198 familje, Korçë 50 familje, Elbasan 72 familje, Gjirokastër 70 familje, Has 10 familje, Kuçovë 13 familje, Krujë 20 familje, Librazhd 20 familje, Gramsh 15 familje.

Shërbimi i Kërkimit

Qëllimi kryesor i Shërbimit të Kërkimit të KKSH është të ndihmojë në rivendosjen e lidhjeve familjare midis anëtarëve të familjeve ose të afërmve, të ndarë si pasojë e luftërave, konflikteve të armatosura, katastrofave natyrore, apo rrethanave të tjera që kërkojnë ndërhyrje humanitare.

Gjatë vitit 2015, Zyra e Kërkimit ka ndjekur rreth 50 raste kërkimi të ardhura nga Shoqatat si motra të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, por dhe nga degët e KKSH në vend. Deri në fund të vitit, është arritur të mbyllen 33 nga raste kërkimi të paraqitura, ndërsa për rastet e tjera vazhdohet ndjekja e tyre sipas procedurave të përcaktuara. Në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), u arrit që të pajisen 30 shtetasve të huaj më dokumente udhëtimi të KNKK;

Kryqi i Kuq Shqiptar, ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura, në fushën e kërkimit, më kuadrin e ndihmës së gjithanshme që po jep Lëvizja ndërkombëtare e KK dhe e GjK në ndihmë të krizës së emigrantëve që ka përfshirë Europën. Pjesëmarrja e Koordinatores së Programit të Kërkimit në takimin vjetor në Dublin; pjesëmarrja bashkë me Nënsekretaren e Përgjithshme të KKSH në takimin e organizuar në Kroaci në muajin nëntor dhe qëndrimi për një javë në një nga kampet pritëse për refugjatët në Gevgelja, Maqedoni për marrje eksperience, i kanë shërbyer pikërisht kësaj përgatitje. ■

PROGRAMI I SHËRBIMIT TË TRAJNIMIT PËR NDIHMËN E PARË

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Zhvillimi i kurseve të trajnimit të Ndihmës së Parë (NP) me kandidatët drejtues të automjeteve, si dhe rritjen cilësore të këtij shërbimi;
2. Zhvillimi i kurseve të NP për kompani private ndërtimi dhe prodhimi, firma, institucione, OJF, studentë të Fakultetit të Mjekësisë, publikun e gjerë dhe grupe shenjë në rrezik në zbatim të udhëzimeve të Qendrës Globale të Referencave për NP.

Shërbimi i Trajnimit për NP si objektiv kryesor ka ofrimin e një shërbimi sa më profesional për zhvillimin e kurseve të NP me kandidatët drejtues automjeti në zbatim të Rregullores, si dhe rritjen cilësore të këtij shërbimi sipas standardeve dhe udhëzimeve të Qendrës Globale të Referencave për NP, e cila ka licencuar KKSH për zhvillimin e Kurseve të NP për kategori të ndryshme.

Për rëndësinë që Shërbimi i Trajnimit për NP, si një faktor i rëndësishëm për fondet e shoqatës, në bashkëpunimin me institucione të larta të shtetit si Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, etj, programi i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të kurseve të NP me kandidatët për drejtues automjeti dhe rritjes së cilësisë së tyre.

Rritja e disiplinës dhe profesionalizmit dhe kryerja me përgjegjësi dhe korrektësi e procesit mësimor të këtyre kurseve, kanë qenë objekt i monitorimeve të vazhdueshme, gjatë vitit dhe në të gjitha degët. Për një proces monitorimi larg subjektivizmit, shërbeu dhe kontrolli i autorizuar nga KZLN, një OJF e pavarur, e cila ndihmoi në evidentimin e problemeve dhe në marrjen e masave për korrektimin e tyre.

Për vitin 2015 kanë zhvilluar kursin e NP për drejtues automjeti me dëshminë përkatëse 55 565 persona. Krahasuar me një vit më parë, ka një rritje prej 5% të kursantëve.

Kursi i Instruktorëve të NP. Me qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore të degëve për një zhvillim normal të kurseve të NP, u zhvillua Kursi për Instruktorë të NP në të cilën u trajnuan 21 instruktorë të rinj nga 15 degë të KKSH.

Për forcimin dhe rritjen e cilësisë së zhvillimit të

Kurseve të NP për drejtues automjeti, më 31 tetor u zhvillua një takim i zgjeruar me sekretarët dhe instruktorët e NP e të 39 degëve të KKSH. Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KKSH theksuan rëndësinë e Kurseve të NP dhe zbatimin rigoroz të Rregullores së zhvillimit të tyre.

Zhvillimi i kurseve të NP për kompani private ndërtimi dhe prodhimi, firma, institucione, OJF, studentë të Fakultetit të Mjekësisë, publikun e gjerë dhe grupe shenjë në rrezik

Ofrimi i kurseve të NP për kategori të përcaktuara, siç janë institucione, subjekte, por dhe për grupe shenjë të publikut, mbetet një detyrë e rëndësishme e programit.

Falë një pune përgatitore disa vjeçare dhe krijimit të kapaciteteve njerëzore e materiale, KKSH është në gjendje sot të ofrojë kurse të specializuara trajnimi të NP për Institucione publike shtetërore dhe jo shtetërore, për studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe të Infermierisë, për personelin e zjarrfikësit dhe Policinë Rrugore, etj.

Mbështetur në Kodin e Punës, në Ligjin nr. 10 053, neni 753 dhe në Rregulloren "Për organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", KKSH ka zhvilluar në 23 degë të tij kurse trajnimi të NP me institucione shtetërore dhe private, (kompani të ndryshme, studentë të mjekësisë) në të cilat janë trajnuar dhe pajisur me Certifikatë të NP 1870 persona. Me gjithë se një shifër në rritje, ajo është shumë larg nevojave në vend për njohuri të Ndihmës së Parë.

Duke qenë se KKSH ka një strukturë të shtrirë në të gjithë vendin, kapacitetet materiale dhe njerëzore, por dhe specializimet e nevojshme të certifikuara nga institucionet përkatëse për dhënien e NP, shoqata po shikon të gjitha mundësitë për të zhvilluar veprimtari të ndihmës së parë në publik, siç është ndihma e parë në bregdet, etj.

Programi do të vazhdojë të insistojë në rritjen e standardeve dhe cilësisë së Kurseve që zhvillon si dhe në mundësinë e zhvillimit të kurseve të NP për kategori të tjera në nevojë.

Kryqi i Kuq Shqiptar zhvillon:

1. **Kurse të NP për kandidatë drejtues të automjeteve;**
2. **Kurse të NP për personelin e Institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore;**
3. **Kurse të NP për studentët e Fakulteteve Mjekësi dhe Infermieri;**
4. **Kurse të NP për Instruktorë të KKSH;**
5. **Kurse të NP për personelin e PMNZSH dhe të Policisë Rrugore;**
6. **Kurse të NP për vullnetarë të KKSH.**

PROGRAMI I SHËNDETIT

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Rritja e nivelit të njohurive të popullatës në fushën e shëndetit riprodhues dhe sëmundjeve infektive (veçanërisht SIDA); Higjienës Personale dhe Higjienës në komunitet;
2. Plotësimi i disa prej nevojave shëndetësore të popullatës në rast katastrofash;
3. Përcaktimi i treguesve dhe standardeve të cilësisë së shërbimeve në fushën e shëndetit.

Veprimtaritë e KKSH në fushën e shëndetit, kanë njohur zhvillime të kënaqshme, si në numrin e pjesëmarrësve, në numrin e përfituesve, në numrin e vullnetarëve dhe në aspektin e shtrirjes gjeografike. 33 degë të KK janë angazhuar në veprimtari dhe projekte të ndryshme të programit të shëndetit. Përfituesit, pjesëmarrësit apo vullnetarët aktivë në këto veprimtari, janë nxënës të shkollave të mesme, studentë të universiteteve, punonjës të ndërmarrjeve prodhuese, qytetarë e banorë të fshatrave, anëtarë të komuniteteve në nevojë,

Me qëllim orientimin dhe mobilizimin e degëve, kryesisht të mesme dhe të vogla për një përfshirje më të madhe në veprimtaritë e Programit të Shëndetit, në fillim të vitit 2015, u zhvilluan në degët e KK Korçë, Elbasan dhe Tiranë, takime rajonale me sekretarët e degëve, koordinatorët e projekteve të programit në degë dhe vullnetarë aktive të përfshirë në veprimtari. Projektet kryesore të zhvilluara janë:

Projekti : Parandalimi i HIV/AIDS-s".

Qëllimi i projektit është "Informimi i të rinjve dhe i popullatës në përgjithësi për HIV/AIDS" dhe synon përfshirjen e të gjithë degëve të KK në këtë veprimtari gjatë gjithë vitit, si dhe informimin dhe sensibilizimin e të rinjve, nëpërmjet veprimtarive më cilësore dhe më të shumta në numër.

Në këtë projekt është punuar për përgatitjen, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të ndryshme informative e sensibilizuese, si fletë palosje dhe postera me tematikë HIV/AIDS; në realizimin e seancave të informimit e të ndërgjegjësimit me nxënësit e vitit të fundit të shkollave nëntëvjeçare, me nxënësit e shkollave të mesme, me studentë të universiteteve dhe të rinj të ndërmarrjeve prodhuese; në zhvillimin

e aktiviteteve kulturore e sportive me temë HIV/AIDS; në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të larmishme për 1 dhjetorin, Ditën ndërkombëtare të luftës kundër HIV/AIDS, në të gjitha degët e KKSH.

Si rezultat, të gjithë degët e KKSH janë angazhuar në veprimtaritë e zhvilluara, por ndër to dallohen 12 degët e mëdha dhe 5 të mesme që organizuan veç të tjerave dhe marshimin e përvitshëm me pjesëmarrje masive të vullnetarëve e nxënësve të shkollave. Më 1 dhjetor 2015 vetëm në Tiranë morën pjesë në marshimin e organizuar mbi 1 800 nxënës e vullnetarë aktivë të KKSH. Kontribut i rëndësishëm për realizimin e veprimtarive dha ERNA (Rrjeti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq kundra HIV/AIDS)

Projekti: "Higjiena Personale".

Projekti ka si qëllim promovimin e vlerave të higjienës personale dhe përftimin e shprehive praktike nga nxënësit e ciklit të ulët dhe fëmijët e grupit të madh të kopshteve për fëmijë, synon realizimin e bisedave te informimit dhe të demonstrimeve praktike sipas kritereve të përcaktuara për secilën degë me qëllim që fëmijët të fitojnë elementë e shprehi të higjienës personale.

Veprimtaritë kryesore të projektit kanë qenë: prodhimi dhe shpërndarja e materialeve informative; zhvillimi i bisedave të informimit dhe demonstrimi në praktike nga vullnetarë të KK të veprimeve për një higjienë të plotë; shpërndarja e materialeve bazë për higjienën personale, dhe pajisja e fëmijëve me furça dhe pasta dhëmbësh për fëmijët e familjeve në nevojë. Zhvillimi i analizës së rezultateve të projektit, falë plotësimit të disa pyetësorëve tregon për një përvetësim të kënaqshëm të njohurive të transmetuara.

Gjatë vitit shkollor, përfituesit e projektit kanë qenë nxënës të ciklit të ulët të shkollës dhe gjatë verës fëmijë të grupeve të larta të kopshteve. Vullnetarët e KK kanë zhvilluar biseda dhe demonstrime praktike me fëmijët për higjienën personale. Një punë e mirë në projekt është bërë për ripërtëritjen e materialit bazë të bisedave, standardizimin e tyre, ilustrimet figurative dhe demonstrimet praktike. Këtë vit, është insistuar veçanërisht për një angazhim të vullnetarëve më afër problemit, siç janë studentë të stomatologë,

studentë të mjekësisë, mësues, etj. Në degën e KK Dibër është arritur të realizohen vullnetarisht, vizita mjekësore nga mjek stomatolog e okulist. Shpesh, në veprimtaritë e zhvilluara, vullnetarët kanë kërkuar pjesëmarrjen e prindërve. Në degë të veçanta, si në Kuçovë, janë organizuar mini konkurse me fëmijët e shkollave, si një metodë për rezultate më të mira e të qëndrueshme.

Projekti :"Higjiena në komunitet".

Qëllimi i projektit është sensibilizimi i popullatës për rëndësinë dhe ndikimin në shëndet të higjienës në komunitet. Projekti ka synuar realizimin e aktiviteteve masive sensibilizuese dhe higjienizuese sipas kritereve të përcaktuara, bazuar në kapacitetet e tyre, si dhe tërrheqja dhe pjesëmarrja e vetë komunitetit në veprimtaritë masive.

Vullnetarët e degëve të KK kanë punuar me

TABELË PËRMBLEDHËSE E AKTIVITETEVE VJETORE TË PROGRAMIT SHËNDETËSOR 2015

Projekt/Aktivitetet	Higjiena Personale	HIV/AIDS	Higjiena në komunitet	Përfitues rreth	Pjesëmarrës	Vullnetar
Nr. i bisedave	587			18 000		284
Nr. i seancave		660		20 000		410
Nr. aktiviteteve			88	Komuniteti	6290	790

DISA TË DHËNA PËR VEPRIMTARITË E ZHVILLUARA MË 1 DHJETOR

Degët	Vullnetarë	Pjesëmarrës	Përfitues
Tirana	50	1800	1850 dhe komuniteti
Degët e mëdha	180	3070	3250 dhe komuniteti
Degët e mesme	12	266	278 dhe komuniteti
Degët e vogla	35	550	585 dhe komuniteti
Total	**277**	**5686**	**5963**

intensitet për të tërhequr vëmendjen, për mobilizimin dhe bashkëpunimin me komunitetin, në funksion të qëllimit të më sipër. Veprimtaritë e zhvilluara në Ditën Botërore të Shëndetit, në Ditën Botërore të Mjedisit, në Ditën e Pastërtisë, kanë qenë kombëtare për nga shtrirja gjeografike. Kështu, më 5 Qershor, në Ditën Botërore të Mjedisit, 21 degë të KKSH organizuan aksione masive higjienizuese me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm vullnetarësh, të rinjsh të shkollave dhe të komunitetit; më 20 nëntor në kuadër të iniciativës "Ta pastrojmë Shqipërinë në një ditë" 12 degë të KKSH, kryesisht të qyteteve të mëdha, morën pjesë në mënyrë masive në veprimtari higjienizuese, duke bashkëpunuar ngushtë me shoqatën "Green Line", shoqata të tjera dhe organizata si World Vision. Për të tërhequr gjithnjë e më shumë anëtarë të komunitetit, vlen të theksohet si element suksesi, bashkëpunimi i ngushtë me shkollat, autoritetet vendore dhe median lokale.

Veprimtari të tjera

1 dhjetori, Dita Ndërkombëtare kundër HIV/AIDS: veprimtaritë e realizuara në këtë ditë në degën e KK Tiranë dhe në të gjitha degët e shoqatës janë të shumta dhe të shumëllojshme.

Në datat 28/29/shtator në Bishkek të Kyrgizstanit, u mbajt nga ERNA takimi i koordinatorëve të shëndetit dhe koordinatorëve të projekteve shëndetësore për HIV/AIDS dhe TBC nga shoqatat kombëtare të Kryqit të Kuq nga vende të Azisë dhe Europës, përfshi shoqatën tonë. Një nga qëllimet e takimit ishte zbatimi në praktikë i Strategjisë dhe Planit të veprimit 2016-2020 të FNKK, në Programet e Shëndetit të Shoqatave Kombëtare, lidhur me HIV/AIDS, TBC dhe Hepatitin C.

Programi i Shëndetit ka përgatitur materiale dhe ka kontribuuar në 2 work-shope të programit të katastrofave gjatë 2015, lidhur me masat, qëndrimet dhe veprimet e anëtarëve të komuniteteve në raste katastrofash, natyrore apo shoqërore, ku kemi thyerje, deformim dhe përkeqësim të konditave higjieno-sanitare dhe të kujdesit shëndetësor. ■

PROGRAMI I PROMOVIMIT TË DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Sensibilizimi i publikut të gjerë dhe organizimi i sesioneve të dhurimit vullnetar falas të gjakut në bashkëpunim me Bankën Kombëtare të Gjakut;
2. Rritjen e kapaciteteve të KKSH për një veprimtari afatgjatë në fushën e dhurimit vullnetar falas të gjakut;
3. Organizim i fushatës me rastin e Ditës Botërore të Dhuruesve Vullnetar të Gjakut më 14 Qershor.

Mjekësia transfuzive në vendin tonë dhe në botë është në zhvillim të shpejtë. Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH) është angazhuar prej vitesh në promocionin e dhurimit vullnetar falas të gjakut, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut të gjerë.

Me qëllim që të kontribuohet maksimalisht për një shërbim transfuzional 100% nga dhurues vullnetare e falas të gjakut, programi synon të promovojë dhurimin vullnetar falas të gjakut, në grupet shenjë me risk të ulët, me objektiv rritjen e numrit të dhurimeve vullnetare, duke siguruar kështu një sasi gjithnjë e më të madhe gjaku të sigurt.

Bazuar në objektivat e KKSH dhe të Federatës Ndërkombëtare të KK dhe GjK, dhe mbështetur në "Deklaratën e Melburnit 2002", e cila i bën thirrje të gjithë vendeve në mbarë botën që të arrijnë sigurimin e gjakut të mjaftueshëm e të sigurt në masën 100% nga dhurimet vullnetare falas të gjakut deri në vitin 2020, KKSH zbaton Programin e promocionit të dhurimit vullnetar të gjakut nëpërmjet dy projekteve: "Promovimi i dhurimit vullnetar, falas të gjakut" që zbatohet në të gjitha degët e KK në vend; dhe "Klubi Shqiptar 25" që zbatohet në degët kryesore të tij.

Projekti: "Promovimi i dhurimit vullnetar e falas të gjakut" zbatohet në të gjitha degët e KKSH.

"Dhuro gjak, Shpëto Jetë" është slogani që përcillet në publik nga degët e KK në të gjithë vendin. Nëpërmjet bashkëpunimit me median elektronike e masmedian, përfshirjen në veprimtarinë e programit të personave publik; përdorimit të rrjeteve sociale; përgatitjes të materialeve promocionale e informative, gjatë këtij viti është arritur të realizohet sensibilizimi, edukimi, motivimi i grupeve shenjë

dhe i publikut, për pasojë është afruar një numër më i madh dhuruesish.

Si çdo vit, falë angazhimit të degëve, programi e shtriu veprimtarinë e tij, në të gjithë vendin, dhe më konkretisht në institucione shtetërore dhe private; në shkollat e mesme dhe ato të larta, në njësitë ushtarake dhe efektivat e policisë të shtetit, në institucionet shëndetësore, kompani e ndërmarrje prodhuese, komunitetet fetare, etj.

Një fushatë mjaft e rëndësishme kombëtare u organizua me rastin e 14 Qershor, Ditës botërore të dhuruesve vullnetar të gjakut, në të cilën u angazhuan rreth 450 vullnetar të KKSH. Të gjitha veprimtaritë e programit për këtë fushatë u zhvilluan nën moton "Ju faleminderit, më shpëtuat Jetën". Fushata u fokusua në falënderimin e dhuruesve të gjakut dhe në inkurajimin e njerëzve që të dhurojnë gjak në mënyrë vullnetare dhe rregullisht. Një kontribut të çmuar dhanë shumë figura publike, ndërmjet tyre dhe Kryeministri, z. Edi Rama me stafin e tij në kryeministri.

Gjatë këtij viti, vlen të përmendim bashkëpunimin me Federatën Kombëtare të Futbollit në ndeshjen Shqipëri – Francë dhe angazhimin e saj maksimal në promocionit të dhurimit vullnetar të gjakut. Kjo ngjarje e rëndësishme sportive pati një jehonë mjaft të madhe në publik. Gjatë vitit 2015, bazuar në një planifikimi vjetor shoqata:

- Ka organizuar 1220 seanca sensibilizimi në degë.
- Janë ofruar për të dhuruar 7332 persona.
- Kanë dhuruar gjak 6397 persona, 13.2 % me shumë se një vit më parë.
- Janë aktivizuar 530 vullnetarë të KKSH.
- Ka organizuar 18 emisione në TV dhe radio, ku është trajtuar gjaku dhe nevojat për të.
- Janë trajnuar 46 vullnetarë, staf në 6 degë të KK.

Nga viti 2006 e deri në vitin 2015, falë kontributit të KKSH në këtë fushë janë siguruar rreth 49.000 njësi gjak, prej nga kanë marrë trajtim me transfuzion gjaku rreth 150.000 pacientë.

Dhurimi vullnetar i Gjakut është rritur 10 fish, nga 5% në 2006 – 25% 2015, ndërsa dhënësit me

pagesë nga 80% janë ulur në 8% në 2015. Numri i njësive të gjakut të mbledhur nga dhurues vullnetar dhe pa pagesë është rritur në 10.4 për 1000 banorë. Rezultatet e arritura janë shumë efikase dhe kanë rritur reputacionin që gëzon KKSH në publikun e gjerë në vend. Synimi ynë është që në një të ardhme të afërt të arrihet në 15 dhurues vullnetar gjaku për 1000 banorë.

Projekti: "Klub 25"

Drejtimi kryesor i projektit: *Sensibilizimi dhe rekrutimi i sa më shumë të rinjve deri në moshën 25 vjeç si dhurues vullnetar të gjakut, dhe ruajtja e dhuruesve të rregullt të gjakut, me qëllim sigurimin e një gjaku të mjaftueshëm dhe të sigurt.*

Të rinjtë janë pjesa më e shëndetshme e popullsisë, që mund dhe duhet të kontribuojë në shëndetin e përgjithshëm të popullsisë dhe në mirëqenien e komunitetit ku jetojnë.

Projekti përfshin të rinj nga mosha 16 deri në 25 vjeç dhe shtrihet në 8 degët e KK Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Berat, Gjirokastër. Fokusi i punës së projekti "Klubit 25" ka qenë promovimi i dhurimit vullnetar të gjakut, shtrirja e veprimtarive të tij në Shkollat e Mesme në degët ku nuk është i përfshirë, dhe organizimi i seancave të sensibilizimit dhe dhurimit në universitetet e vendit.

Rezultatet e arritura:

- "Klub 25" numërohen 310 anëtarë, nga të cilët 150 janë dhurues të rregullt gjaku;
- Nën moton "Ne, ambasadorët e promovimit të dhurimit vullnetar të gjakut", është organizuar sensibilizim dhe informim për një gjak të mjaftueshëm e të sigurt në 45 shkolla të mesme të vendit;
- Për një shtrirje më të gjerë të projektit janë trajnuar 140 vullnetarë të rinj;
- është organizuar një workshop ndërkombëtar me temë "Së bashku për dhurimin vullnetar të gjakut", me përfaqësues nga KK i Maqedonisë, i Italisë dhe i Kosovës. U shkëmbyen
- një kontribut të madh dhanë anëtarët e "Kubit 25" në fushatën kombëtare me rastin e Ditës Botërore të Dhuruesve Vullnetar të Gjakut. 40 % e numrit të dhuruesve të gjakut janë të rinj, të sensibilizuar nga vullnetarët e Klubit 25;

Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e arritura:

- Mbështetja e Federatës Ndërkombëtare të KK dhe GjK, Shoqatat simotra etj.
- Angazhimi dhe mbështetja e plotë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucionet shtetëror në përgjithësi;
- Kontributi maksimal i medias;
- Realizimi i fushatave sensibilizuese, kombinuar me rekrutim aktiv të dhuruesve potencial dhe me mbledhjen e gjakut nga bankat e gjakut;

• Mobilizimi, angazhimi i vullnetarëve anëtarë të Klubit 25;

Ne besojmë shumë se problemet që ndeshen si: mungesa e kulturës dhe informacionit mbi dhurimin vullnetarë të gjakut, dhe motivimi dhe respektimi i dhuruesit vullnetar të rregullt, do të tejkalohen duke treguar një vëmendje të më të madhe dhe një vlerësimin të tij, nëpërmjet një bashkëpunimi më të ngushtë me QKTGJ dhe partnerët e tjerë të interesuar në këtë fushë.

Së bashku me stafin dhe vullnetarët e degëve të KK, do të synohen rezultate gjithnjë e më të larta, duke kontribuar kështu në arritjet e objektivit kombëtar që është 100% dhurues vullnetare e pa pagesë deri në vitin 2020.

Projekti: "Telemjekësia nëpërmjet telefonisë celulare" (Telemjekësia)

KKSH në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Fondacionit "Vodafone Albania" dhe stafin mjekësor të Qendrave Shëndetësore, vuri për herë të parë në zbatim në vendin tonë, projektin "Telemjekësia nëpërmjet Telefonisë celulare". Projekti ofron shërbim mjekësor në zonat më të largëta të vendit, duke realizuar në praktikë ekzaminim bazë mjekësor në rreth 300 fshatra në zonat më të thella vendit. Projekti realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe në koordinim me mjekun e familjes dhe stafin mjekësor vendas atje ku shërbimi shëndetësor mungon, ose ka kufizime.

Në vitin e tretë të zbatimit të projektit të Telemjekësisë nga KKSH, u ekzaminuan rreth 8 500 pacientë dhe u realizuan 42 000 teste mjekësore. Aplikacioni mjekësor "tablet" solli trefishimin e numrit të pacientëve. Ekzaminimet e kryera janë EKG, Spirometër, Oksimetër, matje të tensionit arterial, të glicemisë, të kolesterolit dhe të triglicerideve.

70 % e pacientëve ose rreth 6400 pacientë. janë persona me aftësi të kufizuar dhe mosha e tretë. Nga vizitat e kryera, është arritur të diagnostifikohen pacient me diabet, dislipidemi, hypertension, sëmundje kardiake dhe respiratore, etj.

Pjesë e projektit në këtë fazë, ishte dhe hartimi i statistikave sipas patologjive dhe rretheve për pacientët e ekzaminuar për herë të parë, një kopje e të cilës është dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Krahas ekzaminimeve të ndryshe, bazuar në planifikimin gjithëvjetor, projekti është angazhuar në veprimtari të organizuara si Panairi Mjekësor, (mars, nëntor), duke realizuar një numër prej 400 pacientësh të ekzaminuar dhe 2 000 teste mjekësore.

Falë rezultateve dhe kapaciteteve të krijuar, projekti arriti të akreditohej nga Qendra Kombëtare Edukim në Vazhdim (QKEV), duke rritur shumë perspektivat e zbatimit dhe të mbështetjes së tij. ■

PROGRAMI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Pasqyrimi sa më i plotë i veprimtarive të KKSH, kryesisht në median sociale, dhe në median qendrore të vendit, rritja e kërkesës ndaj degëve dhe programeve për një cilësi në rritje të veprimtarive që zhvillohen;
2. Realizimi në kohë i botimeve të shoqatës dhe insistimi për një shpërndarje sa më të planifikuar të tyre.

Dy kanë qenë drejtimet për një pasqyrim më të plotë të veprimtarive të shoqatës: organizimi i medias sociale në dispozicion të shoqatës: faqes së Facebook-ut dhe faqes së Internetit të KKSH. Kështu, u morën masat e nevojshëm organizative për hapjen e faqeve të facebook-ut (në nivel selia, ka nisur të funksionojë në fund të muajit mars, në 17 degë të nivelit të parë dhe të dytë një muaj më vonë), si dhe u riorganizua tërësisht faqja e Internetit të KKSH. Falë punës së bërë në vazhdimësi, dhe trajnimit "Për mirëmbajtjen e faqes së Facebook-ut dhe pasqyrimit në media të veprimtarive të degëve" të organizuar, degët kanë përmirësuar pasqyrimin e veprimtarive të tyre, çka ka ndikuar në cilësinë e këtyre veprimtarive në realitet. Në faqen e Facebook-ut dhe atë të Internetit të KKSH, kanë gjetur vend gjithashtu veprimtaritë dhe politikat e Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe të GjK.

Pasqyrimi në median e veprimtarive të KKSH.

Programi ka bashkëpunuar me programet për pasqyrimin në median qendrore dhe atë lokale të veprimtarive kryesore të shoqatës nëpërmjet dërgimit të Komunikatave të shtypit. Veprimtaritë kryesore të shoqatës për këtë periudhë që kanë gjetur vend në median e shkruar dhe atë vizive, janë ato që lidhen me veprimtaritë në nivel kombëtar të KKSH, të tilla si "Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe", "Dita Botërore e Dhuruesve të Gjakut", "Dita Botërore e Ndihmës së Parë", "Dita Botërore kundra AIDS", "Dita botërore vullnetarizmit", apo veprimtaritë e Programit të Promocionit të dhurimit vullnetar të gjakut, Programit të të Rinisë dhe të Edukimit humanitar, Programit Social, Programit të përgatitjes dhe ndërhyrjes në raste katastrofash, që kanë

pasur një gjeografi të gjerë, etj., si dhe ngjarje me rëndësi për shoqatën si vizita e Presidentit të Federatës ndërkombëtare të KK dhe GjK z. Tadereu Konoe, apo dhe zhvillimet e Mbledhjeve statutore të Lëvizje.

Kujdes është treguar në realizimi në kohë të botimeve të shoqatës, të botimeve në varësi të programit apo dhe të atyre të planifikuara nga programet e tjera. Janë botuar dhe shpërndarë numrat e radhës të Revistës të Kryqit të Kuq Shqiptar Nr. 64 dhe 65 si dhe është botuar në kohë Raportit Vjetor i KKSH 2014.

Panairi "Klik Expo Group" ka qenë një tjetër eveniment i veçantë, në të cilën shoqata mori pjesë për herë të parë. Kësaj veprimtarie iu dha një vëmendje e veçantë për një përfaqësim sa më mirë.

Programi ka qenë pjesë aktive e veprimtarive të zhvilluara si për hartimin e Strategjisë 2020 të KKSH, në procesin OCAC për vetëvlerësimin e shoqatës të zhvilluara me FNKK, e po kështu dhe në procesin e hartimit të Planit të Veprimit 2016. Ai ka qenë aktivë në veprimtaritë e zhvilluara nga programet e tjera që kanë kërkuar pjesëmarrjen e tij. ■

PROGRAMI I FUNKSIONIMIT ORGANIZATIV

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. rritja e kapaciteteve të organeve të zgjedhura (governancës) dhe forcimi i rolit të saj drejtues në zhvillimin e KKSH;
2. përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve menaxhuese të shoqatës.

Mbështetur në Planin e Veprimit të vitit 2015, Programi i Funksionimit Organizativ është fokusuar në punën për rritjen e rolit të organeve të zgjedhura (governancës) në drejtimin dhe zhvillimin e KKSH. Ishte pikërisht ky qëllimi që aktiviteti i parë i rëndësishëm, në fillim të vitit ishte organizimi i një takimi me Kryetarët e Degëve të KK dhe Kryetarët e Komisioneve të Financës në Degë. Temat kryesore që u trajtuan ishin : "Funksionimi i Degës, i Këshillit të Degës, i Kryetarit të Degës, i Kryetarit të Komisionit të Financës në degë dhe lidhja e tyre me menaxhimin" bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të KKSH.

Si organi më i lartë drejtues ndërmjet dy Asambleve, Këshilli Drejtues ka zhvilluar rregullisht mbledhjet e tija, në respekt të normave Statutore të shoqatës. Kështu, janë zhvilluar gjashtë mbledhje në të cilat është raportuar për veprimtarinë e shoqatës, për veprimtarinë financiare të saj, është miratuar Plani i Veprimit dhe Buxheti për vitin 2016, si dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për jetën e shoqatës siç janë: amendimi i rregullave 20, 21, dhe 47 të Rregullores së Brendshme të KKSH, si një domosdoshmëri për të përqasur më shumë dokumentet bazë të shoqatës me realitetin e ri. Këshilli Drejtues ka miratuar gjithashtu, propozimet e bëra për të futur në Planin e Veprimit 2015, bashkëpunimet me Organizatën Botërore të Ushqimit, me Fondacionin "Vodafone Albania", apo me organizatën World Vision etj. Një vendim i rëndësishëm i Mbledhjes së muajit qershor, ishte miratimi i propozimit të bërë nga Presidenti i FNKK-së për angazhimin e KKSH të procesit e emërtuar "Vlerësimi i kapacitetit organizative dhe certifikimit të shoqatës". Mbledhja e e fundit e muajit dhjetor. pati një rëndësi të veçantë, pasi në të u diskutua dhe miratua Plani

i Veprimit dhe Buxheti i shoqatës për vitin 2016. Këshilli Drejtues është informuar rregullisht në mbledhjet e tij për të gjitha problemet apo çështjet e ndryshme që kanë qenë pjesë e punës apo e shqetësimeve të shoqatës.

Gjatë vitit 2015, janë zhvilluar rregullisht mbledhjet e Këshillave në degëve, në respektim të kalendarit të përcaktuar që në fillim të vitit. Mbledhjet janë zhvilluar sipas Rendit të Ditës, në përputhje me normat e Statutit dhe Rregullores.

Komisioni i Parimeve dhe i Garancive Statutore është mbledhur disa herë gjatë vitit. Në mbledhjet e tij ai ka shqyrtuar dhe miratuar dokumente dhe çështje me rëndësi për shoqatën. Kështu, Komisioni, pasi diskutoi dhe analizoi në detaje Planin e Veprimit të KKSH për vitin 2015, ai ja paraqiti atë për miratim Këshillit Drejtues, bashkë me disa rekomandime.

Gjithashtu, Komisioni mori në shqyrtim disa ndryshime në Rregulloren e Brendshme për një përputhje sa më të mirë me mënyrën e re të organizimit të shoqatës. Në këtë këndvështrim, Komisioni trajtoi gjithashtu rishikimin e Rregullores së funksionimit administrativ dhe të Rregullores Financiare, ndryshime që ju paraqitën për miratim Këshillit Drejtues.

Komisioni i Vrojtim Verifikimit ka zhvilluar disa monitorime në degët e KK Patos, Mirditë, Vlorë, Dibër etj, lidhur me punën e Këshillave të Degëve, Dosjet e Këshillit, zbatimin e Statutit dhe Rregullores së Brendshme të shoqatës, por dhe funksionimin e Këshillit të Degës dhe të Degës në tërësi, etj.

Veprimtari të tjera të zhvilluara:

Në muajin shkurt u zhvillua një takim me sekretarët e degëve të KK të nivelit të parë, për realizimin me sukses të kurseve të NP me kandidatët për drejtues të automjeteve. Në këtë takim u paraqitën dhe objektivat për realizimin Planit të Veprimit dhe Buxhetit për vitin 2015.

Në muajin mars u zhvillua një takim me sekretarët e degëve të KK për nënshkrimin e marrëveshjeve dhe kontratave të punës. Në këtë takim u vu dhe një herë, theksi në zbatimin me përpikëri të Planit të veprimit dhe të Buxhetit për vitin 2015.

Në muajin maj, zhvilloi një vizitë në Kryqin e Kuq Shqiptar, Presidenti i FNKKGjK, z. Tadateru Konoe. Ai u takua me vullnetarë, të zgjedhur dhe punonjës të KKSH, si dhe zhvilloi takime me autoritete të larta të vendit, si me Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, z.Ilir Meta, Zëvendës Kryeministrin z. Niko Peleshi etj., gjatë të cilave, ai kërkoi një mbështetje më të madhe për KKSH në përmbushje të misionit të tij humanitar.

Hartimi i Strategjisë 2016-2020 të KKSH, ka qenë një tjetër objektiv i rëndësishëm i veprimtarisë së shoqatës gjatë 2015-ës. Procesi i hartimit të saj, nisi me një takim të gjerë të organizuar në shtator me aktorë të ndryshëm të shoqatës. Takimi u asistua nga e dërguara e FNKK, znj. Nicoline Mascini, e cila gjatë gjithë kohës mbështeti procesin e hartimit të strategjisë. Në fund të muajit nëntor u hartua një draft i Strategjisë, që u shpërnda në Seli dhe në degë për një diskutim më të gjerë, për sugjerimet dhe vërejtjet përkatëse.

Një tjetër proces i rëndësishëm i iniciuar nga KKSH është ai i "Vlerësimit të kapaciteteve organizative dhe certifikimi" (OCAC). Për këtë proces, në muajin tetor u zhvillua në Qendrën Kombëtare të Trajnimit të KKSH, një takim i drejtuar nga z. Patrick Vinberg dhe z.Roger Fischli, të dërguar të FNKKGjK. Një raport vlerësues mbi gjendjen e shoqatës, do të përmbyllë fazën e parë të këtij procesi. ■

PROGRAMI I RINISË DHE EDUKIMIT HUMANITAR

DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT:

1. Promovimi dhe zhvillimi i vullnetarizmi tek të rinjtë, si një angazhim qytetar në drejtim të promovimit të vlerave humanitare;
2. Promovimi dhe rritja e rolit të lidershipit tek të rinjtë në drejtim të vendimmarrjes, ofrimit të shërbimeve, rolit ndihmës për njerëzit në nevojë dhe partneritetit;
3. Promovimi i Parimeve themelore të Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe të GjK dhe edukimit humanitar tek të rinjtë, si mjete për të ndryshuar mendimet, për të shpëtuar jetë dhe për të rritur tolerancën.

Bazuar në drejtimet e Strategjisë për Rininë të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, në përvojën e viteve të shkuara në punën me vullnetarët dhe të rinjtë, Programi ka organizuar punën në tre drejtime: "Të rinjtë si vullnetarë; Të rinjtë si lider; Të rinjtë si përfitues".

Programi synon të promovojë dhe zhvillojë vullnetarizmin tek brezi i ri, veçanërisht në drejtim të promovimit të vlerave humanitare dhe të Parimeve themelore të Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe të GjK, me qëllim që t'i aftësojë ata si lidera të ardhshëm në vendimmarrje, në ofrimin e shërbimeve, dhe në dhënien e kontributit në komunitet.

Gjatë vitit 2015, numri i vullnetarëve në KKSH është 2746 persona, 70 % e të cilëve janë të rinj.

Një ndër veprimtaritë me një histori prej afër dy dekadash është Ekspozita XIX Kombëtare e Vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq".

Ekspozita Kombëtare e Vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq" nga ka marrë dhe emrin projekti është përmbyllja e një fushate, me një shtrirje rreth 4 mujore, në të cilën përfshihen të gjitha degët e KKSH në mbarë vendin, dhe u jep atyre mundësinë që të bashkëpunojnë me grupet e vullnetarëve dhe liderat e rinisë, me kolektivat e shkollave dhe institucione të tjera vendore, shtetërore dhe private. Në këtë fushatë intensive informimi, u përfshinë 164 shkolla 9-vjeçare, si dhe u realizuan 243 seanca sensibilizimi me nxënësit e moshës 9-14 vjeç, në 17 degë të mëdha e të mesme të KKSH. Seancat u organizuan nga 142 të rinj vullnetarë me eksperiencë e të trajnuar në fushën e promovimit të vlerave humanitare. Në këto seanca u përfshinë rreth 6,500 nxënës. Rezultat i kësaj pune intensive është shtimi i interesit të nxënësve për veprimtarinë e Kryqit të Kuq dhe pasqyrimi

i ideve në punimet e tyre në ekspozitat e vizatimit të organizuara nga degët.

Si rezultat i fushatës intensive të zhvilluar në periudhën janar – prill u hapën 37 ekspozita vizatimi, për realizmin e punimeve të pasqyruar u angazhuan nxënësit e 202 shkollave 9 vjeçare në të gjithë vendin. Në 37 ekspozitat e organizuara u ekspozuan rreth 3,000 vizatime, piktura, punime dhe aplikacione që kishin në qendër veprimtarinë e Kryqit të Kuq në Shqipëri dhe në botë.

Fituesit dhe punimet më të mira do të konkurronin në Ekspozitën XIX Kombëtare të Vizatimit që u organizua më 8 maj në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë. Në këtë ekspozitë u paraqitën rreth 350 punime nga të gjitha degët e Kryqit të Kuq. E rëndësishme është jehona që ekspozitat në rrethe dhe ajo kombëtare, gjetën në mediat lokale dhe ato kombëtare. Analiza dhe vlerësimi në përmbyllje të gjithë kësaj veprimtarie, përmban një moment të rëndësishëm në përcaktimin e hapave të nevojshëm për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Realizimi i këtij projekti tradicional, veçanërisht në drejtim të promovimit të vlerave humanitare, është një moment i rëndësishëm në përgatitjen dhe shtimin e numrit të anëtarëve dhe të vullnetarëve të ardhshëm të shoqatës.

Konkurs për vlerat humanitare "Rinia dhe Kryqi i Kuq"

Viti 2015 është vitit i kremtimit të 50-vjetorit të miratimit të Parimeve Themelore të Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe të GjK, parime këto që rregullojnë veprimtarinë e kësaj lëvizje në mbarë botën. Pikërisht, kjo ngjarje e rëndësishme, nxiti organizimin e Konkursit të parë kombëtarë "Rinia

dhe Kryqi i Kuq" që synonte promovimin e e këtyre parimeve në masën e të rinjve vullnetarë. 6 ekipe nga degët më të mëdha të Kryqit të Kuq me 36 pjesëmarrës do të ishin dhe protagonistët e këtij konkurrimi, të zhvilluar më datën 3 tetor 2015 në Qendrën Kombëtare të Trajnimit në Tiranë. Skuadra fituese u shpall skuadra e Degës së KK Tiranë. Në përshëndetjen e tij në mbyllje të konkursit, Presidenti i KKSH z. Ylli Alushi, shprehu vlerësimet më të mira për rëndësinë e këtij konkursi, duke uruar një vijimësi sa më të madhe për të tilla veprimtari në jetën e shoqatës.

Konkursi shërbeu për një angazhim më cilësor të të rinjve vullnetarë si dhe shtimin e njohurive të tyre për KKSH, Lëvizjen Ndërkombëtare të KK dhe të GjK, Parimet themelore dhe përhapjen e vlerave humanitare që mbartin ato.

12 Gusht – Dita Botërore e Rinisë dhe 5 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit.

700 të rinj vullnetarë nga 12 degë të KKSH u përfshinë në veprimtari masive të organizuara në këto dy ditë të shënuara. Pastrimi i mjedisit, sensibilizim i komunitet, veprimtari të NP në komunitet, veprimtari në shtëpitë rezidenciale të të moshuarve, janë disa nga veprimtaritë e organizuara nga të rinjtë. Nën sloganin "Rinia në Veprim", të rinj vullnetarë të degës së KK Tiranë pedaluan në bulevardin qendror të qyteti. Jehona në median qendrore dhe atë lokale i bëri këto veprimtari më të afërta për publikun e gjerë.

Kampi veror për lider rinie

Kampi veror për lider rinie është konsideruar si një veprimtari e rëndësishme për përgatitjen e lidërve

të ardhshëm të të rinjve vullnetar të KK. Ishin përfaqësues të të rinjve vullnetar të degëve të KK Tiranë, Durrës, Vlorë, Lezhë, Korçë, Dibër, Elbasan, Berat, Fier, Gjirokastër, Pogradec, Kavajë dhe Lushnjë, pjesëmarrës në kamp. Këtë vit morën pjesë dhe 3 të rinj vullnetarë përfaqësues të KK të Kosovës, nga Degët e KK Prishtinë, Podujevë dhe Mitrovicë.

Kampi i rinisë, i zhvilluar në një nga Shtëpitë e Pushimit në malin e Dajtit, në periudhën 10-15 gusht, synoi të gërshetonte anën motivuese dhe argëtuese me atë edukative. Nëpërmjet seancave plenare, punës në grupe, role-play, lojërave të ndryshme, të rinjtë tentuan të përmirësojnë aftësitë e tyre në drejtim të përhapjes së njohurive të KK dhe të Parimeve themelore të Lëvizje ndërkombëtare, si dhe në të qenët lider për organizimin e të rinjve vullnetarëve në veprimtaritë në shërbim të komunitetit.

Të rinjtë pjesëmarrës morën gjithashtu njohuri për dhënien e NP, në përgatitjen në raste katastrofash, si dhe shkëmbyen përvojën e tyre të deritanishme, brenda KKSH dhe me bashkëmoshatarët e tyre nga KK i Kosovës.

Në mbështetje të drejtimeve të programit gjatë vitit 2015 u zhvilluan tre trajnime:

Gjatë këtij viti u zhvilluan dy trajnime për lider rinie. Trajnimet u fokusuan në rritjen e aftësive të të rinjve vullnetarë të KKSH për të qenë lider rinie me qëllim përhapjen e vlerave humanitare dhe mëshirimin e tyre në veprimtarinë e përditshme. Për këtë qëllim, në trajnimet u trajtuan tema që ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të të rinjve vullnetarë si lidera rinie në degë, por dhe në rritjen e njohurive mbi Lëvizjen ndërkombëtare të KK dhe të GjK dhe të Parimeve Themelore. Shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet të rinjve pjesëmarrës, për sa i takon rolit të liderit dhe grupit, solli diskutime në funksion të objektivit të trajnimit.

Një trajnim tjetër në funksion të organizimit të fushatës promovuese "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq" ishte ai i zhvilluar me 36 mësues të vizatimit nga 36 degët e KKSH, të angazhuar vullnetarisht në Konkursin Kombëtar të Vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq". Rritja e cilësisë së punimeve të nxënësve pjesëmarrës, ishte qëllimi i këtij takimi. ■